



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Prill 2021

Nr: 234

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj kryetarit të bashkisë Vorë, z. Gentian Picari

Kërkues: Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: Bashkia Vorë
Kryetari z. Gentian Picari

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 79 pika 1, 92, 171 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak



Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim me shkrim, administruar pranë KQZ-së me shkresën nr. 2798 prot., datë 29.03.2021, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga ana e kryetarit të bashkisë Vorë.

Sipas denoncimit të datës 29.03.2021, protokolluar me shkresën nr. 2798 prot., datë 29.03.2021 pranë KQZ -së, të subjektit politik LSI, pretendohet se: *“Bashkia Vorë nuk ka zbatuar vendimin nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.”*

Në datë 15.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 140, ka marrë një vendim detyrues kundrejt Bashkisë Vorë, e cila duhet të merrte masat e menjëhershme që t’i përmbahej afatit të përcaktuar në nenin 79, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për rihapjen e faqes së internetit.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatori apo Kas-it. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi LSI përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 15.03.2021, me vendimin nr. 140, pas shqyrtimit administrativ të denoncimit të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, ka vendosur që, kryetari i bashkisë Vorë duhet të merrte masat e menjëhershme për aksesimin e faqes së internetit për zbatimin e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të internetit, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 15.03.2021. Gjithë të interesuarit mund të dispononin përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Komisionerit” duke filluar nga kjo datë.

Administrata e KQZ-së verifikoi se faqja e web-it të bashkisë Vorë vazhdon ende të mos jetë hapur edhe pas vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Me datë 08.04.2021 ora 14:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të kërkesave të nenit 88 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” zhvilloi një seancë dëgjimore me palët në këtë proces administrativ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 80 “Kodi i Procedurave Administrative”, i kërkoi z. Gentian Picari, të japë sqarime lidhur më çështjen.

Për palën e kallëzuar në seancë u paraqitën z. Gentian Picari. Për palën kallëzuese u paraqit në seancë përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim z. Altin Kaziaj.

Përfaqësuesi i palës së kallëzuar z. Gentian Picari në shpjegimet e tij, ka parashtruar se ka ndërmarrë të gjitha hapat që parashikon ligji për riaktivizimin e faqes së bashkisë Vorë, duke deklaruar se disponon të gjitha shkresat drejtuar agjencive të cilat krijojnë mundësinë e aktivizimit të faqes web.

Z. Gentian Picari pretendon se, ka mbajtur korrespondencë elektronike dhe shkresore, pra një kronologji të gjitha shkresave, duke filluar nga data 06.01.2021, të cilat i ka adresuar me shkresën me nr. 333 prot., AKSH-it për suport teknik, AKEPIT dhe IKUB-it duke deklaruar se ende nuk ka marrë një përgjigje.

Përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim deklaroi se kryetari i bashkisë Vorë edhe pse ka pasur një iniciativë për të komunikuar me autoritetet përgjegjëse për hapjen e kësaj faqeje nuk ka pasur një vullnet të mirë për vënien në dispozicion të këtij informacioni.

Në seancën e datës 08.04.2021 u administruan nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve provat e kryetarit të bashkisë, Vorë, si më poshtë:

- Shkresa nr. 3035 prot., datë 07.04.2021, administruar në KQZ me nr. 3621 prot., datë 12.04.2021, nëpërmjet së cilës bën me dije informacion mbi problematikën e faqes zyrtare të webi-t të bashkisë Vorë. Me shkresën nr. 2842 prot., datë 01.04.2021, ka vendosur në dispozicion të KQZ-së kërkesën për suport teknik drejtuar AKSHI-t, nëpërmjet së cilës ka kërkuar marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të ndodhur në faqen e web-it zyrtar të bashkisë Vorë, që është hostuar te serveri virtual i AKSHI-t.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet email, më datë 10.04.2021, drejtuar kryetarit të bashkisë Vorë, z. Gentian Picari, i ka kërkuar të bëjë me dije, hapat që ka ndërmarrë në zbatim të vendimit nr. 140 datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Bashkia Vorë nëpërmjet email të datës 13.04.2021, ka vendosur në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve praktikën shkresore të komunikimit më AKSHI-n dhe IKUB-in, nr. 3172 prot., datë 13.04.2021, administruar me nr. 3709 prot., datë 13.04.2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3694 prot., datë 13.04.2021, ka kërkuar informacion nga AKSHI, mbi pretendimet e kryetarit të bashkisë Vorë, z. Gentian Picari.

Agjencia Shqiptare e Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 2219/1 prot., datë 14.04.2021, ka sqaruar se: *“Website i Bashkisë Vorë është ndërtuar si pjesë e projektit “Planning Local Government Project”. Ky është një projekt midis Bashkisë dhe operatorit ekonomik që ka fituar të drejtën e zhvillimit dhe implementimit të projektit. Në këtë rast AKSHI ka kontribuar në project duke vënë në dispozicion resurse infrastrukturore në formën e serverëve virtual të dedikuar, pra ne garantojmë vetëm kushtet optimale të resurseve infrastrukturore dhe komunikimit (kushtet e hostimit). Përgjegjësia rreth përmbajtjes dhe shërbimeve që ofrohet nga këto servera është e Bashkisë Vorë. Në komunikimet elektronike, AKSHI-t i është kërkuar diagnostikimi i problemit, ku ne kemi konfirmuar se resurset infrastrukturore dhe komunikimi janë në gjendje optimale dhe problemi qëndron në nivel shërbimi brenda në servera, pra është jashtë përgjegjësisë së AKSHI.”*

III. Analiza juridike dhe konkluzione

Në përputhje me parashikimet e nenit 81 të ligjit nr. 44/2015 *Kodi i Procedurës Administrative*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga kryetari i bashkia Vorë z. Gentian Picari, çmon sipas bindjes së tij, se dokumentet e pranuar si prova të cituara më sipër, nuk janë të mjaftueshme për të provuar mungesën e përgjegjësisë së tij për mosmarrjen e masave për rihapjen e faqes së internetit.

Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencive Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar, si dhe përmbushjes së detyrave funksionale të AKSHI-t mbi ofrimin e shërbimeve të përqendruara qeveritare, AKSHI garanton kushtet optimale të resurseve infrastrukturore dhe komunikimit (kushtet e hostimit).

Bashkia Vorë ka përgjegjësi rreth përmbajtjes së shërbimeve që ofrohen nga këto servera.

Referuar komunikimeve me anë të email-it zyrtar ndërmjet Bashkisë Vorë dhe AKSHI-it çmohet se, faqja e web-it është në administrim të bashkisë Vorë. Kredencialet e serverit janë dhënë në momentin e krijimit të serverit dhe ato nuk zotërohen nga ana e AKSHI-it.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, mospërmbushja e detyrimit nga kryetari i bashkisë Vorë, për hapjen e faqes së web-it të bashkisë Vorë, përbën shkelje të

parashikuar 79, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 7, pika 1, germa “c” e Vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se, “*shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë*”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” e “n”, pika 2, dhe nenet 79 pika 1, 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Gentian Picari, Kryetar i Bashkisë Vorë, në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

